



NJË fushëbetejë E RE VIRTUALE

Si të parandalohet radikalizimi nëpërmjet internetit në hapësirën kibernetike të Ballkanit Perëndimor?

Përmbledhje e Studimit për Sigurinë Kibernetike (dhe Radikalizimin nëpërmjet Internetit) në Ballkanin Perëndimor




Regional Cooperation Council

Mirë. Më mirë. Rajonal.



financuar nga BE-ja

Ky botim financohet nga BE-ja. Ai pasqyron vetëm këndvështrimet e autorit(ëve). Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal dhe BE nuk mbajnë përgjegjësi për çfarëdo përdorimi të informacionit në përmbajtje të këtij dokumenti.




Kjo broshurë mbështetet në studimin për sigurinë kibernetike (dhe radikalizimin nëpërmjet internetit) në Ballkanin Perëndimor, i porositur nga Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal, në kuadër të Veprimit Rajonal IPA II 2016 për parandalimi dhe lufta kundër ekstremizmit të dhunshëm (P/CVE).


Objektivi kryesor i studimit është ofrimi i një **përmbledhjeje gjithëpërfshirëse dhe analizimi i situatës së sigurisë kibernetike dhe radikalizimit nëpërmjet internetit** në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë*, Mal të Zi, Serbi, dhe Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë (Ballkani Perëndimor 6 apo BP6), si dhe **dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e sigurisë kibernetike dhe parandalimin e radikalizimit nëpërmjet internetit**

*Ky emërtim nuk paragjykon qëndrimet për statusin, dhe është në përputhje me UNSCR 1244 dhe me Mendimin e GjND-së për deklaratën e pavarësisë së Kosovës.

Vështrim i përgjithshëm i mjedisit të internetit në botë



Vështrim i përgjithshëm i mjedisit të internetit në rajon




Siguria Kibernetike

Koncepti mbizotërues rreth sigurisë kibernetike, që sulm kibernetik dhe krim kibernetik konsideron vetëm sulmet ndaj pajisjeve fizike apo kibernetike, dhe nuk përfshijn edhe operacionet për mbledhjen e informacionit në internet, si për shembull: radikalizimin nëpërmjet internetit, përdorimin e gjuhës së urrejtjes, si dhe lajmet e rreme, është i tejkaluar dhe jo më i përshtatshëm.




Studimi *Një fushëbetejë e re - Si të parandalohet radikalizimi nëpërmjet internetit në fushën e sigurisë kibernetike në Ballkanin Perëndimor* e zgjeron me tërësisht mënyrën se si ne e kuptojmë sigurinë kibernetike duke i përfshirë të dy konceptet e lartpërmendur. Ai pasqyron ndërgjegjësim të rritur të RCC-së se roli i internetit në operacionet për mbledhjen e informacioneve nuk dhe nuk duhet të konsiderohet i izoluar nga fushat e tjera të sigurisë kibernetike.



Sa i gatshëm është rajoni për këtë qasje?

400
Numri i sulmeve të sigurisë kibernetike të raportuara në Ballkanin Perëndimor në vitin 2017



Siguria Kibernetike



2015 Anketë e Eurobarometrit e vitit 2015 rreth shqetësimeve më të zakonshme të përdoruesve të internetit:

→ **43%** janë të shqetësuar për keqpërdorimin e të dhënave të tyre personale



→ **42%** janë të shqetësuar për sigurinë e pagesave të bëra në internet



→ **18%** nuk kishin shqetësime për veprimet bankare në internet apo pagesat e bëra në internet



BE-ja ka investuar 334 milion euro për sigurinë kibernetike në periudhën nga viti 2007 deri në vitin 2013

2007 - 2013



2014 - 2020

Investime të mëtejshme nga viti 2014 deri në vitin 2020 janë planifikuar të arrijnë në shumën e 450 milion euro



334 milion €



450 milion €



CSIRT

Ekipet e Reagimit ndaj Incidenteve të Sigurisë Kompjuterike (CSIRTs)



Të gjitha Ekipet e Reagimit ndaj Incidenteve të Sigurisë Kompjuterike (CSIRT) pjesë e BP6 kanë funksione të ngjashme; megjithatë, nivelet e tyre të funksionalitetit nuk janë të njëjta në të gjitha ekonomitë.

Asnjë nga CSIRT-të kombëtare në BP6 nuk janë agjenci të pavarura, dhe pozicionimi i tyre në qeveri është i ndryshëm në të gjithë rajonin.


Përmbledhje

e informacioneve dhe gjetjeve përkatëse për secilën nga 6 vendet e Ballkanit Perëndimor



	SHQIPËRIA	BOSNJE DHE HERCEGOVINA	KOSOVA*	ISH REPUBLIKA JUGOSLLAVE E MAQEDONISË	MAL I ZI	SERBIA
Konventa e Budapestit për Krimet Kibernetike	Ratifikuar 2002 Pika e kontaktit (PeK) 24/7	Ratifikuar 2006 PeK 24/7	PeK 24/7	Ratifikuar 2004 24/7 PeK	Ratifikuar 2010 PeK 24/7	Ratifikuar 2009 PeK 24/7
CIRT kombëtare	✓ 2016	Funksionim shumë i kufizuar 2017	✓ 2016	✓ 2016	✓ 2012	✓ 2016
Ligji për sigurinë kibernetike	✓ Miratuar 2017	✗	✓ Miratuar 2010	✗	✓ Miratuar 2010	✓ Miratuar 2016
Strategjia e sigurisë kibernetike	Akte politikash ,në vend të saj, 2015-2017	✗	Strategjia dhe Plani i Veprimit 2016	Strategjia e miratuar në korrik të vitit 2018	Strategjia dhe Plani i Veprimit 2018-2021 (Strategjia e dytë.)	Po, ndërsa Plan Veprimi nuk ka 2017
Arsim i shkallës së tretë për Sigurinë e Informacionit	✗	✓	✓	✓	✓ shumëdisiplinor	✗
LKEDH/Strategjia e terrorizmit përfshin referenca për pjesën kibernetike/në internet	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Sfidat kyçe	Eksptertizë teknike dhe financiare dhe aksesimi dhe mbajtja e personelit					

- CSIRT-të nuk kanë fonde, personel të mjaftueshëm dhe kapacitetin teknologjik të nevojshëm
- Raportimi i incidenteve: shoqëritë, në veçanti, i druhen prishjes së reputacionit në raste të rrjedhjes së informacioneve në media; mungesës së besimit në zbatimin e ligjit; mungesës së kapaciteteve për identifikimin e sulmeve në çastin kur ndodhin
- Hetimet dhe procedurat: vuajnë nga pamjaftueshmëria e aftësimit profesional dhe kapacitetet e pamjaftueshme
- Partneritetet publike private (PPP): mungesa e traditës së PPP-ve në rajon; mungesa e kërkesave për të tilla nisma; mosbesimi i qeveritë të BP6 ndaj ekspertëve vendas të TIK-ut (parapëlqim i ekspertëve ndërkombëtarë)
- Arsim: mungesë e dukshme e politikave arsimore për TIK-un dhe për sigurinë në BP6
- Media: mungesë e theksuar e njohjes dhe raportimit të saktë për sigurinë kibernetike në shumicën e vendeve të BP6
- Largimi i personave të kualifikuar: përqindje të larta të migrimit nga rajoni të profesionistëve me përvojë të TIK-ut
- Ndërgjegjësim i ulët për rreziqet e mungesës së sigurisë kibernetike në rajon



Radikalizimi në internet

Ekstremistët e dhunshëm dhe terroristët...

...kanë kohë që e përdorin internetin për qëllime komunikimi dhe bashkëpunimi mes tyre, por edhe për të bindur të tjerë që tu bashkohen. Pikërisht këtu përqendrohet Studimi për Sigurinë Kibernetike (dhe Radikalizimin nëpërmjet internetit) në Ballkanin Perëndimor.



Roli i internetit në procesin e radikalizimit është i qartësisht i dukshëm në të 6 vendet e Ballkanit Perëndimor, megjithatë, ndërveprimet personale mbeten të rëndësishme.

Kritikët e ligjërimit bashkëkohor të radikalizimit...

...pretendojnë se 'radikalizimi' lidhet kryesisht me terrorizmin e dhunshëm xhihadist dhe shumë më pak i pranishëm në diskutimet rreth llojeve të tjera të ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit, siç është ekstremizmi i djathtë.



Vetëm dy nga vendet BP6 nuk kanë strategji në nivel kombëtar...

...për luftën kundër radikalizimit dhe/ose ekstremizmit të dhunshëm, por edhe ato vende që e kanë, mbeten pas për sa i përket masave zbatuese të tyre.

Mangësitë kryesore që lidhen me zbatimin e strategjive për luftën kundër radikalizimit:

Burime të kufizuara të personelit, teknologjisë dhe trajnimeve në organe si policia dhe prokuroritë




Pjesëmarrje e kufizuar e shoqërisë civile

Mungesë e konsiderueshme e partneriteteve publike private

Nevojë për raportim më të kujdesshëm në media


Mungesë e politikave dhe programeve arsimore për identifikimin e përmbajtjeve të rrezikshme në internet

Radikalizimi në internet




Gjatë kulmit të aktivitetit në internet në vitin 2015, Shteti Islamik (IS) prodhonte afërsisht 1,200 përmbajtje zyrtare në muaj, duke përfshirë albume me fotografi, grafikë informacioni, revista në PDF dhe video. Padyshim që IS-ja nuk janë të vetmit terroristë aktivë në internet.

Ekzistojnë një sërë ekstremistësh të dhunshëm, grupesh terroriste dhe mbështetës të tyre janë aktualisht të angazhuar në një shumëllojshmëri veprimtarish në internet.




Ka 70% më shumë mundësi që në Twitter të ripostohen informacionet e rreme sesa ato të vërtetat



1,500 njerëz informohen mesatarisht 6 herë më shpejtë për lajmet e rreme se ato të vërteta

Gjatë periudhës 2012-2017, rreth 1,000 individë (burra, gra, fëmijë, të moshuar) nga Ballkani Perëndimor kanë udhëtuar drejt Sirisë dhe Irakut, 300 prej të cilëve janë rikthyer, më shumë se 200 janë vrarë, rreth 400 vazhdojnë të jenë atje, ndërsa disa të tjerë konsiderohen të humbur.



SHQIPËRIA

PËRDORUES TË INTERNETIT NË DHJETOR TË VITIT 2017

1,932,024



SIGURIA KIBERNETIKE



- Nuk ka Strategji të plotë për Sigurinë Kibernetike, megjithatë Dokumenti për Sigurinë Kibernetike 2015 - 2017 e zëvendëson mungesën e saj



- Në strukturat e Policisë së Shtetit dhe Prokurorisë së Përgjithshme funksionojnë njësi të posacme për krimin kibernetik



- Sipas vlerësimit të BE-së së vitit 2018 për Kapitujt 10 dhe 24, Shqipëria është pak e përgatitur për sigurinë e informacioneve, ndërsa ka pasur përparime për sa i përket planit të veprimit për agjendën digjitale dhe shërbimeve qeveritare elektronike

- Pjesa më e madhe e krimeve kibernetike lidhen me mashtrimin, hakimin, përndjekjen në internet dhe ndërhyrjet në të dhëna



RADIKALIZIMI NË INTERNET



- Në rreth 70% të rasteve, përhapja e mesazheve ekstremiste ka ndodhur përmes komunikimit të drejtpërdrejtë, ndërsa 30% përmes internetit



- Mediat sociale nuk janë kanali më i rëndësishëm i përhapjes së përmbajtjeve ekstremiste në Shqipëri



BOSNJA DHE HERCEGOVINA

PËRDORUES TË INTERNETIT NË DHJETOR TË VITIT 2017

2,828,846



- Sipas vlerësimit të BE-së së vitit 2018 për Kapitujt 10 dhe 24, Bosnja dhe Hercegovinës i mungon një kuadër strategjik [në nivel shtetëror] për trajtimin e çështjes së krimeve kibernetike dhe kërcënimeve të sigurisë kibernetike. Sipas raportimeve, rrallëherë kryhen hetime për krimet kibernetike.



- Llojet kryesore të krimeve kibernetike janë sulmet DoS[1] dhe DDoS[2], mashtrimet në internet, ndërhyrja e paautorizuar në sistemet kompjuterike, mashtrimet përmes kartave të kreditit, abuzimet në rrjetin pa fije (wireless), veprimtaritë që lidhen me abuzimin seksual të fëmijëve në internet, shkeljet e të drejtave të autorit në internet, abuzimet në rrjetet sociale, shpërndarja e malware-ve (viruse kompjuterike), nxitja e urrejtjes, mosmarrëveshjeve apo intolerancës, si dhe nxitja publike e terrorizmit dhe propagandës terroriste



- Në BeH ende nuk ekziston një kulturë e sigurisë së informacionit, ka një mungesë të ndërgjegjësimit dhe të kuptimit të pasojave të mundshme



SIGURIA KIBERNETIKE



RADIKALIZIMI NË INTERNET



- Interneti shihet si "përgjegjës" për lehtësimin e krijimit dhe përhapjes së një game të gjerë rrjetesh transnacionale, duke përfshirë këtu rrjetet Salafi dhe Xhihadiste. Diaspora e madhe e BeH-së, që ka kontingjente të njohur Salafi në Austri, Gjermani, Holandë, Slloveni dhe Suedi, komunikon me anë të internetit.



- Megjithatë, lidhjet ndërpersonale mes individëve të komuniteteve dhe komunikimet e drejtpërdrejta ballëpërballë mes individëve kanë luajtur rol më të rëndësishëm



- Retorika nacionaliste në BeH tërheq më shumë vëmendje se sa roli i internetit për radikalizim



- Në vitin 2017, BIRN ka zbuluar më shumë se 60 faqe interneti me bazë në Ballkanin Perëndimor, që promovonin idenë e shteteve etnikisht të pastra, neonazizmin, homofobinë e dhunshme dhe politika të tjera të radikalizmit të djathtë

[1] Në informatikë, një sulm përmes mohimit të shërbimit (Sulm DoS) është një sulm kibernetik me anë të të cilit autori synon që të bëjë një makineri apo një burim rrjetesh të padisponueshëm për përdoruesit e tyre të synuar, duke ndërprerë përkohësisht apo përgjithmonë shërbimet e një host-i të lidhur me internetin
 [2] Një sulm i shpërndarë përmes mohimit të shërbimit (DDoS) është një përpjekje keqdashëse për të ndërprerë trafikun e zakonshëm të një serveri, shërbimi apo rrjeti të shënjestruar, me qëllim shkatërrimin e shënjestrës apo infrastrukturës së saj rrethuese përmes një vërshimi të trafikut në internet

ISH REPUBLIKA
JUGOSLLAVE E
MAQEDONISË

PËRDORUES TË INTERNETIT NË DHJETOR TË VITIT 2017

1,583,315



SIGURIA KIBERNETIKE


- Sipas vlerësimit të BE-së së vitit 2018 për Kapitujt 10 dhe 24, Kodi Penal i Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë është kryesisht në përputhje me standardet e BE-së, pasi ndërmjet krimeve të tjera ka shpallur abuzimin seksual të fëmijëve në internet dhe krimin kompjuterik si vepra penale. Digjitalizimi i ekonomisë po përparon me ritme të shpejta
- Nuk ka një ligj gjithëpërfshirës për sigurinë kibernetike, megjithatë, në korrik të vitit 2018 është miratuar një strategji për sigurinë kibernetike
- Është ngritur CSIRT-ja kombëtare në vitin 2016
- Shumica e sulmeve kibernetike ishin të llojit DoS dhe vjedhje e informacioneve, por shpërndarja e software që e shkaktojnë dëmin po shtohet, ndërkohë që shumica e përdoruesve të internetit nuk janë të ndërgjegjshëm për këtë kërcënim



janë shënuar


75

sulme
kibernetike
në vitin 2017



RADIKALIZIMI NË INTERNET

- Përmbajtjet ekstremiste dhe terroriste janë lehtësisht të aksesueshme përmes internetit, sidomos nëpërmjet mediave sociale



KOSOVË*

PËRDORUES TË INTERNETIT NË DHJETOR TË VITIT 2017

1,523,373



- Sipas vlerësimit të BE-së së vitit 2018 për Kapitujt 10 dhe 24, Kosova* ka bërë përparime shumë të mira në fushën e sigurisë kibernetike dhe ka një legjislacion shumë të mirë. Megjithatë, problematikat më të mëdha lidhen me zbatimin, që ende nuk është në masën e kërkuar.
- Qeveria ka caktuar një pikë kontakti 24 me 7 në njësinë e krimit kibernetik të policisë
- Llojet më të zakonshme të krimeve kibernetike përfshijnë mashtrimin përmes kartave të kreditit, lajmet e rreme (p.sh: përmes e-maileve të falsifikuara të dërguara medias), ndërhyrjet në privatësinë e kompjuterëve, sulmet DDoS, phishing, etj.
- Marrëdhëniet ndërmjet sektorëve publikë dhe privatë janë të mira, sidomos për sa i përket ofruesve të shërbimit të internetit. Megjithatë, bashkëpunimi nuk është në nivelin që duhet të jetë



SIGURIA KIBERNETIKE



RADIKALIZIMI NË INTERNET

- IS-ja ka prodhuar përmbajtje në internet në gjuhën shqipe që synon shqipfolësit në Shqipëri, Kosovë*, dhe Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, por me fokus të veçantë Kosovën*
- Përpos rolit të rëndësishëm të mediave sociale, një sërë raportesh për veprimtarinë e IS-së në Kosovë* theksojnë rëndësinë e medias masive tradicionale dhe të procesit të rekrutimit



Interneti ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm në procesin e radikalizimit të luftëtarëve të huaj të Kosovës*

439,624

Statistikat sipas vitit dhe llojit të sulmit



	SULME NDAJ FAQEVË TË INTERNETIT dhe IS	MASHTRIMI NË INTERNET	ABUZIMI I PROFILEVE SOCIALE	PËRMBAJTJE E PAPËRSHTATS HME NË INTERNET	MALWARE	TË TJERA
2013	5	3	10	-	1	3
2014	5	6	20	5	-	6
2015	6	17	37	19	17	36
2016	18	20	36	14	50	25
2017 (deri më 1 shtator)	90	13	25	4	245	8
Gjithsej	124	59	128	42	313	78

janë shënuar
385
sulme kibernetike në vitin 2017

- Sipas vlerësimit të BE-së së vitit 2018 për Kapitujt 10 dhe 24, Mali i Zi nuk ka kryer një vlerësim rrënjësor të kibernetikës dhe sigurisë kibernetike
- Në vitin 2017 Qeveria ngriti Këshillin e Sigurisë së Informacionit
- Spektori privat në Malin e Zi po përparon në fushën e sigurisë kibernetike, me disa ofrues të shërbimit të teknologjisë së informacionit që janë nismëtarë në këtë fushë prej 15 vitesh
- Mali i Zi po përparon shumë shpejt lidhur me legjislacionin dhe politikën e sigurisë kibernetike



SIGURIA KIBERNETIKE



RADIKALIZIMI NË INTERNET

#3

Në Mal të Zi ekzistojnë tre lloje kryesore të ekstremizmit:

- Tekfirizmi i dhunshëm (i quajtur në këtë raport 'xhihadizmi i dhunshëm')
- Salafizmi jo i dhunshëm
- Pansllavizmi dhe ekstremizmi ortodoks

Për sa i përket llojit të fundit, disa malazezë iu janë bashkuar kontingjentit të luftëtarëve të huaj në Ukrainën Lindore

6,325,816



- Sipas vlerësimit të BE-së së vitit 2018 për Kapitujt 10 dhe 24, Serbia ende nuk ka miratuar një strategji për krimet kibernetike



- Funksionimi i CSIRT-së është i kufizuar për shkak të mungesave në personel



- CSIRT në nivel kombëtar është ngritur brenda Agjencisë për Komunikime Elektronike dhe Shërbime Postare, megjithatë në Serbi ekzistojnë edhe lloje të tjera të CSIRT-ve



- Serbia ka një Prokurori të Posaçme për luftën kundër krimet kibernetik



- Fusha e sigurisë së informacionit konsiderohet jo vetëm si një fushë e re ndërgjegjësimi për qeverinë, por edhe si një sfidë e re për sigurinë në përgjithë



- Në përgjithësi ekziston dhe është në përmirësim e sipër bashkëpunimi i mirë ndërmjet sektorit privat dhe qeverisë

janë shënuar

20

sulme kibernetike në vitin 2017



SPAM



- Gjetjet e një ankete të opinionit publik të kryer me të rinjtë nga Sandzak-u, tregojnë se më shumë se gjysma e të anketuarve (52.6%) i konsiderojnë platformat në internet si thelbësore për përhapjen e pikëpamjeve dhe përmbajtjeve ekstremiste

- Thuajse gjysma e të anketuarve (46.7%) të po së njëjtës anketë, janë të mendimit se për sa i përket përhapjes në internet, platformat e medias sociale janë mjeti më i rëndësishëm për propagandën ekstremiste

- Një numër shumë më i ulët i të anketuarve ishin të mendimit se "objektet fetare" janë të rëndësishme për përhapjen e mesazheve ekstremiste (7.1%) apo se të tilla mesazhe janë tepër të përhapura "në komunitet" (8.3%)

- Në vitin 2017, BIRN ka zbuluar më shumë se 30 faqe interneti të ekstremizmit të djathtë në gjuhën serbe

Rekomandime për përmirësimin e sigurisë kibernetike



Të hartohen strategji dhe plane veprimi me kosto efikase gjatë fazës së planifikimit dhe këto plane të zbatohen me anë të fondeve të përkushtuara për to



Të krijohen dhe/ose përmirësohen strukturat e raportimit të incidenteve kibernetike



Të rritet ndërgjegjësimi



Të përdoret në maksimum ekspertiza përmes krijimit të rrjeteve për palët e interesuara



Të identifikohen dhe krijohen Partneritete Publike (PPP) dhe sinergji



Të rishikohet qasja arsimore për TIK-un dhe sigurinë kibernetike

NË NIVEL KOMBËTAR

NË NIVEL RAJONAL

Brenda kuadrit egzistues duhet të zhvillohet një qasje më strategjike bashkëpunimi rajonal

Bashkërendim më i mirë i mbështetjes ndërkombëtare ndaj strategjisë së rajonit

Të krijohet një qendër rajonale për ekselencën



Rekomandime për parandalimin e radikalizmit në internet

✓ Të rishikohen strategjitë për LKEDH-në, që të sigurohet bashkërendim më i gjerë me Strategjinë e BE-së për Luftën kundër Radikalizmit dhe Rekrutimit në Terrorizëm

✓ Të rishikohen strategjitë e LKT-së dhe LKEDH-së, që të sigurohet përputhshmëria dhe plotësimi i Strategjive për Sigurinë Kibernetike


✓ Të rishikohen strategjitë dhe legjislacioni në fushën e TI-së, që të sigurohet përfshirja e sulmeve ndaj sistemeve të informacionit

✓ Të rishikohen marrëdhëniet aktuale me shoqëritë e sektorit privat, organizatat e shoqërisë civile dhe median për zhvillimin e veprimeve që të përmirësohen marrëdhëniet

✓ Të rishikohen dhe zhvillohen reagimet, që të trajtohen problematikat shoqërore për të cilat grupet apo individë mund të përpiqen të gjejnë mbështetje

✓ Të përfshihet mendimi kritik në arsimin për sigurinë kibernetike

NË NIVEL KOMBËTAR



NË NIVEL RAJONAL



Të sigurohet një qasje e qëndrueshme ndaj ekstremizmit dhe përmbajtjeve ekstremiste në internet

Të ndiqet një qasje informacionesh dhe provash, që aksesit në përmbajtje terroriste të bëhet sa më i vështirë dhe i kushtueshëm i mundshëm

Të zhvillohen marrëdhënie më të mira me shoqëritë më të mëdha të teknologjisë dhe forumet e TI-së

Të ngrihet një Njësi Referimi për Ballkanin Perëndimor

Të hartohet dhe miratohet një Agjendë për Sigurinë në Ballkanin Perëndimor

Të krijohet një version i Rrjetit të Ndërgjegjësimit për Radikalizmin për Ballkanin Perëndimor

[10]
YEARS

Powered
by RCC.int

KËSHILLI I BASHKËPUNIMIT RAJONAL

Trg Bosne i Hercegovine 1/V

71000 Sarajevo, Bosnia and Herzegovina

+387 33 561 700

+387 33 561 701

rcc@rcc.int



rcc.int



RegionalCooperationCouncil



@rccint



RCCSec



Regional Cooperation Council



RegionalCooperationCouncil